

**Infrastruktur & Umwelt Professor Bohm und Partner Ingenieure – Dega në Shqipëri
Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

PËRMBAJTJA:

FAQE

PASQYRAT FINANCIARE:

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E PERFORMANCËS	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	5
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	6-16

Infrastruktur & Umwelt Professor Bohm und Partner Ingenieure – Dega në Shqipëri
Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat janë në Lekë)

Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2018

	Shënime	31 dhjetor 2018
AKTIVET		
Aktive afatshkurtra		
Mjete monetare	4	12,604,948
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	11,996,053
Total aktive afatshkurtra		24,601,001
Aktivet afatgjata		
Aktive afatgjata materiale	6	579,719
Total aktive afatgjata		579,719
Total aktive		25,180,720
DETYRIMET		
Detyrime afatshkurtra		
Llogari të pagueshme tregtare	7	167,463
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	8	20,242,116
Detyrime tatimore	9	730,606
Të tjera detyrime	10	89,860
Total detyrime afatshkurtra		21,230,045
Detyrime afatgjata		
Total detyrime afatgjata		-
Totali i detyrimeve		21,230,045
KAPITALI		
Fitimi i ushtrimit		3,950,675
Total kapitali		3,950,675
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		25,180,720

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 16, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Infrastruktur & Umwelt Professor Bohm und Partner Ingenieure – Dega në Shqipëri
Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat janë në Lekë)

Pasqyra e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	11	35,094,635
Të ardhura/shpenzime të tjera të shfrytëzimit neto	12	(483,721)
Lënda e parë, materiale të konsumueshme, shërbime dhe të tjera shpenzime		(29,648,882)
1) Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe shërbime	13	(27,670,800)
2) Të tjera shpenzime	14	(1,978,082)
Shpenzime të personelit	15	(158,914)
1) Paga dhe shpërblime		(136,173)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore		(22,741)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	6	(24,960)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	16	(5,850)
Të ardhura të tjera		-
Shpenzime/të ardhura financiare neto	17	18,527
1) Shpenzime/të ardhura të tjera financiare neto		18,527
Fitimi/humbja para tatimit		4,790,835
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	18	(840,160)
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(840,160)
Fitimi i ushtrimit		3,950,675
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		3,950,675

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 16, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Infrastruktur & Umwelt Professor Bohm und Partner Ingenieure – Dega në Shqipëri
Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat janë në Lekë)

Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

	Fitimi i ushtrimit	Total
Pozicioni financiar më 6 gusht 2018	-	-
Fitimi i ushtrimit	3,950,675	3,950,675
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2018	3,950,675	3,950,675

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 16, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.


Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 janë aprovuar nga administratori i Infrastruktur & Umwelt Professor Bohm und Partner Ingenieure – Dega në Shqipëri më 29 mars 2019 dhe janë firmosur si më poshtë:

Z. Orhan Bulent Boran
Administrator

 **INFRASTRUKTUR & UMWELT**
Professor Böhm und Partner
Branch in Albania Dega në Shqipëri

 **MAZARS**

Rr. Emiri Durraku, Palli "Binjaket",
No. 5, Tiranë, Shqipëri
phone : +355 42 27 80 15
www.mazars.al info@mazars.al


Mazars Shpk
Hartues i Pasqyrave Financiare

(Vlerat janë në Lekë)

**Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi i ushtrimit		3,950,675
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet financiare jomonetare		288,781
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar		693,160
Shpenzime konsumi dhe amortizimi		24,960
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera		(11,996,053)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme		18,163,381
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit		27,288
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit		11,152,192
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale		(604,679)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		(604,679)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Hua të arkëtuara		2,364,743
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		2,364,743
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare		12,912,256
Efekt i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare		(307,308)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	4	12,604,948

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 16, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria Infrastruktur&Umwelt Profesor Bohm und Partner Ingenieure- dega në Shqipëri është regjistruar më 6 gusht 2018 në Regjistrin e Shoqërive.

Shoqëria ka për qëllim të bashkëpunojë profesionalisht në planifikimin, konsulencën dhe menaxhimin e projekteve në fushat e infrastrukturës, zhvillimit mjedisor dhe hapësinor, si dhe zhvillimin organizativ për institucionet publike dhe private në Shqipëri dhe jashtë saj,

Administrator i Shoqërisë është Z. Orhan Bulent Buran.

Shoqëria është e regjistruar pranë degës së Tatim Taksave në Tiranë me NIPT L82006018J. Selia qendrore e saj është në Zona Administrative nr. 5, Rruga Brigada VIII, Pallati 6/2, Kati IV, Tirana 1000.

Numri punonjësve më 31 dhjetor 2018 ishte 1 punonjës.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pamundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

(Vlerat janë në Lekë)

3. Politikat kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2018 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	31 dhjetor 2018
Euro/LEK	123.42
USD/ LEK	107.82

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitet financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivitetin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivitetin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

(Vlerat janë në Lekë)

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimmerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

(Vlerat janë në Lekë)

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale. Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2018 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Ndërtesa	Vlera e mbetur	5%
Instalime teknike, makineri dhe pajisje	Vlera e mbetur	20%
Mjete Transporti	Vlera e mbetur	20%
Mobilje dhe pajisje zyre	Vlera e mbetur	20%
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25%
Të tjera	Vlera e mbetur	20%

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

(Vlerat janë në Lekë)

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Shoqëria ka vetëm qira operative.

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2018 është 15%.

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Shoqëria nuk ka burim diferencash të përkohshme për njohjen e tatimi të shtyrë.

(Vlerat janë në Lekë)

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Aktivët dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare më 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>
Mjete monetare në bankë	12,557,736
Mjete monetare në arkë	47,212
	<u><u>12,604,948</u></u>

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>
Klientë	11,996,053
	<u><u>11,996,053</u></u>

Infrastruktur & Umwelt Professor Bohm und Partner Ingenieure – Dega në Shqipëri
Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat janë në Lekë)

6. Aktive afatgjata materiale

	Mobilje orendi	Paisje kompjuterike	Të tjera	Totali
Kosto				
Gjendja më 6 gusht 2018	-	-	-	-
Shtesa	328,583	190,396	85,700	604,679
Pakësime	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2018	328,583	190,396	85,700	604,679
Amortizimi i akumuluar				
Gjendja më 6 gusht 2018	-	-	-	-
Amortizimi i vitit	10,098	11,998	2,864	24,960
Pakësime	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2018	10,098	11,998	2,864	24,960
Vlera neto kontabël				
Gjendja më 6 gusht 2018	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2018	318,485	178,398	82,836	579,719

7. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregëtare më 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2018
Furnitorë vendas	111,078
Furnitorë për fatura të pa mbëritura	56,385
	167,463

8. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Llogaritë e pagueshme ndaj paleve të lidhura më 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2018
Financim nga Infrac.&Umwelt,Prof.Bohm und Partner Ingenieure	2,346,216
Të pagueshme tregëtare Infrastruktur&Umwelt Professor Bohm und Partner Ingenieure	17,895,900
	20,242,116

(Vlerat janë në Lekë)

9. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2018
Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	8,610
Tatimi mbi të ardhurat nga punësimi	111
Tvsh	28,725
Tatimi mbi fitimin	693,160
	730,606

10. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera më 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2018
Pagat e punonjësve	27,288
Financime Mazars Shpk	12,572
Financime nga Orhan	50,000
	89,860

11. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të ardhura nga shitja e shërbimeve të projektimit	35,094,635
	35,094,635

Rakordimi i të ardhurave me FDP-në e TVSH-së

	31 dhjetor 2018
Rakordimi i të ardhurave me FDP-në	
Shitje total te deklaruar në FDP-në e TVSH-së	62,765,435
Autofatura të deklaruar	27,670,800
Shitje të deklaruar në FDP që janë të ardhura në PASH	35,094,635
Shërbim konsulence	35,094,635
Të ardhura të deklaruar në PASH të cilat janë deklaruar shitje në FDP	35,094,635
Fitim nga këmbimet valutore	34,460
Total të ardhura të deklaruar në FDP-në e Tatim Fitimit	35,129,095

(Vlerat janë në Lekë)

12. Të ardhura/shpenzime të tjera të shfrytëzimit neto

Të ardhura të tjera detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Humbje nga këmbimet valutore nga aktiviteti i shfrytëzimit	(491,617)
Fitim nga këmbimet valutore nga aktiviteti i shfrytëzimit	7,896
	(483,721)

13. Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe shërbime

Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Shërbim konsulence nga jashtë vendit	27,670,800
	27,670,800

14. Të tjera shpenzime

Shpenzimet të tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Shpenzime administrative noteriale	185,788
Shpenzime konsulence ekonomike	373,223
Shpenzime telefonie	7,246
Shpenzime interneti	3,629
Shpenzime bankare	45,828
Taksa vendore	3,125
Shpenzime për pritje dhe perfaqesime	136,768
Shpenzime akomodimi për ekspertet e huaj	300,639
Shërbime taksit	62,770
Qira zyra	52,500
Shpenzime për organizim konferenca	43,645
Kancelari	97,663
Qira makina	139,155
Të tjera të panjohura	526,103
	1,978,082

(Vlerat janë në Lekë)

15. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Shpenzime për paga	136,173
Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	22,741
	158,914

Numri punonjësve më 31 dhjetor 2018 ishte 1 punonjës.

16. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Gjoha dhe penalitete	5,850
	5,850

17. Shpenzime/të ardhura financiare neto

Shpenzimet financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Fitim nga këmbimet valutore	26,564
Humbje nga këmbimet valutore financiare	(8,037)
	18,527

18. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Fitimi para tatimit	4,790,835
Shpenzime të panjohura të tjera (si më poshtë)	810,235
Shpenzime pritje dhe përcjellje	31,484
Penalitete, gjoha e dëmshpërblime	5,850
Shpenzime pa faturë të rregullt tatimore	772,901
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	5,601,070
Tatim fitimi 15%	840,160
	3,950,675

**Infrastruktur & Umwelt Professor Bohm und Partner Ingenieure – Dega në Shqipëri
Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

(Vlerat janë në Lekë)

19. Transaksionet me palët e lidhura

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2018
Bilanci kontabël	
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura	
Te pagueshme Trejetare Infrastruktur&Umwelt Professor Bohm und Partner Ingenieure	17,895,900
Financim nga Infrastruktur&Umwelt Professor Bohm und Partner Ingenieure	2,346,216
	20,242,116
	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve	
Blerje nga palët e lidhura	
Infrastruktur&Umwelt Professor Bohm und Partner Ingenieure	27,670,800
	27,670,800

20. Angazhime dhe pasiguri

Çështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Më 31 dhjetor 2018 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

21. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.